



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 12.06.2012, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Kymete Bajraktari dhe Duda Balje.

Munguan: Rita Hajzeraj, Justina Pula dhe Biserka Kostiq.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Të ftuar: z.Hysnija Beshkoviq- zëvendësministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe Edona Hajrullahu- Agjencia për Barazi Gjinore.

Pjesëmarrës të tjerë: Basri Berisha-IAP; Elita Vokshi-OSBE; Nevahir Hazeri-KDI; Natyra Avdiu-YIHR; Pleurat Kurti-EUSR; Flora Kryeziu- UNICEF; Edi Gucia-ABGJ; Terina Dampier-OSBE; Ukë Gashi-ZPRK; Nuredin Ibishi- CDF; Burim Tahiri-praktikant.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1 Miratimi i rendit të ditës;

2. Miratimi procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23 maj 2012;
3. Shqyrtimi i pikës 74.2, 134 dhe 135 të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian,
 - Të ftuar: ministri për Komunitete dhe Kthim dhe Edona Hajrullahu -Agjencia për Barazi Gjinore.
4. Njoftim me kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit, drejtuar Gjykatës Kushtetuese për cenimin e pavarësisë së IAP-it;
5. Të ndryshme.

Kryetarja - Konstatoi se janë plotësuar kushtet për hapjen e mbledhjes.

Ajo i propozoi Komisionit që të bëhet ndryshimi i renditjes së pikave të rendit të ditës dhe propozoi që pika e dytë e rendit të ditës të kalojë në pikën e tretë, për shkak se të ftuarit janë të ngarkuar edhe me punë të tjera.

Komisioni miratoi rendin e ditës me këtë ndryshim.

3. Shqyrtimi i pikës 74.2, 134 dhe 135 të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian

Kryetarja- Pasi përshëndeti të pranishmit, i njoftoi në vija të trasha lidhur me qëllimin e këtij takimi duke kërkuar nga të ftuarit informata lidhur me zbatimin e Planit të veprimit dhe veprimet që janë ndërmarrë në drejtim të përmbushjes së pikës me të cilën e ngarkon raportin në fjalë. Ajo pastaj theksoi se të ftuar për të raportuar për pikat e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës kemi përfaqësuesen e Zyrës për Barazi Gjinore dhe zëvendësministrin për Komunitete dhe Kthim. Sa i përket pikës 135, kemi kërkuar raport nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe kërkoi që ta marrin fjalën sipas radhës.

Edona Hajrullahu- Tha se raporti është hartuar në bazë të hulumtimit që e kemi realizuar në vitin e kaluar me temën: “Gratë në procesin e punës dhe të vendimmarrjes”, ku kanë qenë të anketuara 550 veta, 65% femra dhe 35% meshkuj. Nga ky hulumtim rezulton se legjislacioni ofron një përkrahje të madhe për gjininë femërore, por arritja e barazisë gjinore dhe pjesëmarrja e gruas në pozitë të vendimmarrjes, nuk është për t’u dëshiruar, sepse ka vështirësi në zbatimin e Ligjit për barazi gjinore.

Femrat më të suksesshme janë në sektorin publik, ndërsa sipas hulumtimit, 58% e femrave punojnë në këtë sektor, 26 % e femrave janë të punësuar në sektorin privat, 14 % në organizatat ndërkombëtare dhe 2% në sektorin joqeveritar. Gjithashtu, nga ky hulumtim është vërejtur se pengesat më të mëdha që femrat i hasin janë: procedurat e rekrutimit, stereotipat dhe çështja e nepotizmit, që janë vlerësuar si çështje që i pengojnë femrat në avancimin e tyre në karrierë. Sa i përket politikës dhe vendimmarrjes, mbi 78 % e femrave të anketuara janë shprehur se nuk janë të kënaqura me rolin e gruas në politikë dhe vendimmarrje, ndërsa 22 % mendojnë se roli i gruas në politikë dhe vendimmarrje është i kënaqshëm. Sipas këtij hulumtimi, veçori pozitive e shërbimit civil është ruajtja e vendit të punës dhe qëndrueshmëria në mbajtjen e pozitës. Ky është shembull pozitiv i fuqizimit të gruas, sepse 67 % e femrave të anketuara kanë një përvojë relativisht të gjatë prej 5 deri në 10 vjet, ndërsa 26 % prej tyre janë me përvojë prej 2 deri në 5 vjet, që punojnë në institucione publike. Në bazë të statistikave që

marrim nga ASHC- ja, në vitin 2008, në nivel drejtues ka pasur 10.66 % femra, ndërsa 89.34 % meshkuj, pra në nivelin menaxherial janë 20.6 % femra, ndërsa pjesa tjetër meshkuj. Në vitin 2009 është rritur prezenca e femrave në 11.8 % në nivelin drejtues, po ashtu është rritur edhe në nivelin menaxherial në 22.06 %. Këtu shihet se, nga viti 2008 në vitin 2009, ka pasur ngritje për 7 % në favor të gjinisë femërore në pozita menaxheriale. Në vitin 2010, niveli drejtues është rritur në 12.42 % femra dhe 87.57 % meshkuj, ndërsa në vitin 2011, 13.1 % femra dhe 86.9 % meshkuj, ndërsa ky është viti me përfaqësimin më të lartë të femrave. Sa i përket Agjencisë për Barazi Gjinore, ekziston programi i Kosovës për barazi gjinore, lidhur me këtë çështje ne kemi hartuar planin e veprimit për fuqizimin ekonomik të grave në Kosovë. Në tryezën që kemi pasur më 8 Mars, kemi lansuar me temën: “Fuqizimi i gruas në vendet rurale, sfidat dhe mbështetja institucionale”.

Hysnija Beshković – Tha se ka përmirësim në kuptimin e mbrojtjes shëndetësore.

Po ashtu, ka përmirësim kur është fjala për arsimin, si dhe zgjidhjen e çështjeve banesore, mirëpo mund të themi se nuk jemi të kënaqur me të gjitha të arriturat rreth integritetit të plotë në shoqërinë kosovare. Vlen të theksohet se Ministria për Komunitete dhe Kthim promovon dhe aprovon politikën e cila u jep mundësi të barabartë të gjitha bashkësive, pa e favorizuar asnjë bashkësi. Ne angazhohemi që të jemi të barabartë për të gjitha bashkësitë që jetojnë në Kosovë. Në vitin 2006, përmes planit të Qeverisë, në qytetin e Vushtrrisë janë ndërtuar 20 shtëpi për të rikthyerit, duke i përfshirë 17 shtëpi për pjesëtarët romë dhe është ndërtuar komplet infrastruktura në fshatin Stanovc i Epërm. Po ashtu, përmes këtij projekti, janë ndërtuar 4 shtëpi për komunitetin RAE, ndërsa në Gjilan janë ndërtuar 25 shtëpi për pjesëtarët e komunitetit rom, rregullimi i rrugëve dhe infrastrukturës, si dhe është ndërtuar edhe një qendër partner, mbështetur nga Komuna e Prishtinës dhe organizatat joqeveritare. Në Komunën e Lipjanit, janë ndërtuar 15 shtëpi për bashkësinë ashkali. Në vitin 2008, përmes planit të Qeverisë, janë ndërtuar 4 banesa me nga 20 shtëpi për komunitetin RAE. Gjatë vitit 2008 është ofruar ndihmë dhe janë ndërtuar 72 shtëpi për komunitetin RAE: në Fushë-Kosovë 14 shtëpi, në Gjilan 4 shtëpi, për këtë komunitet në Istog, në dy faza janë ndërtuar 10 shtëpi, në qytetin e Pejës, në fazën e dytë janë ndërtuar 12 shtëpi, ndërsa në një fazë tjetër 11 shtëpi për komunitetin RAE. Kjo ka qenë gjatë vitit 2008. Gjatë vitit 2009 është ofruar ndihmë për bashkësinë romë, ashkali dhe janë ndihmuar gjithsej 69 familje. Gjatë vitit 2010, përmes projektit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe UNHCR-ja, kanë financuar në të gjitha bashkësitë për kthimin e tyre dhe janë ndërtuar 16 shtëpi për komunitetin RAE. Gjithashtu, gjatë vitit 2010, sipas këtij projekti janë ndërtuar 6 shtëpi për këto komunitete. Gjatë vitit 2010, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe UNHCR-ja kanë financuar për ndërtimin e 80 shtëpive për të gjitha bashkësitë, nga të cilat 44 shtëpi për komunitetin RAE. Gjatë vitit 2011 është financuar ndërtimi i 13 shtëpive për pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Gjatë vitit 2012, me plane të përbashkëta në mes Ministrisë dhe Ambasadës Britanike, janë ndërtuar 8 shtëpi për komunitetin rom. Këto kanë qenë detajet për të cilat kemi punuar. Po ashtu, kemi memorandum bashkëpunimi me Malin e Zi, që të mbyllet kampi i këtij komuniteti dhe ata të mos jenë aty, por të kthehen. Ata mund të zgjedhin që të qëndrojnë në Mal të Zi

apo të kthehen në Kosovë. Ajo që është me rëndësi, në kuadër të kompetencave tona, u japim ndihmë të gjithë personave, pa dallim të komuniteteve.

Kryetarja – Duke u ndërlidhur me diskutimin e lartshënuarit, ngriti çështjet shëndetësore, banesore, si dhe u cek çështja e banimit dhe ndërtimit të shtëpive. Ajo kërkoi sqarim lidhur me arsimin dhe me shëndetësinë se çka është ndërmarrë.

Hysnija Beshkoviq – Duke u përgjigjur në pyetjen e kryetares, tha se nuk mjafton vetëm ndërtimi i shtëpive, por duhet të bëhet përpjekje për përparim edhe në çështjet e shëndetësisë dhe të arsimit. Krahas ndërtimit të shtëpive, janë të nevojshme edhe stimulime të tjera, personave të kthyer, përveç ndërtimit të shtëpive, duhet t'u ofrohet edhe ndihma shëndetësore. Sa i përket ndihmës shëndetësore, nuk e di se a kanë këto komunitete ambulanca, sepse për këtë çështje, kompetente është Ministria e Shëndetësisë. Përveç shëndetësisë, duhet të behet përpjekje edhe për përmirësimin e çështjeve të arsimit. Ne e kemi një divizion, i cili merret me çështjet e arsimit për këto komunitete dhe rregullisht është në teren dhe bën sensibilizimin e popullatës që të regjistrohen në shkolla dhe të vijnë në mësimin. Në kuadër të mandatit tonë, t'i kryejmë këto punë dhe t'i integrojmë në shoqëri.

Detyrë e Ministrisë është që të përkujdeset dhe të përkrahë kthimin. Vlen të theksohet se të kthyerit nga Perëndimi, nuk janë në mandatin tonë, por të Ministrisë së Drejtësisë dhe ata i koordinojnë këto punë.

Kymete Bajraktari – Pyeti : A ka statistika se sa persona të kthyer janë punësuar, si dhe sa fëmijë të kthyer e vijnë në shkollimin?

Hysnija Beshkoviq- Iu përgjigj të gjitha pyetjeve të parashtruara nga ana e deputetëve dhe iu premtoi se informatën me shkrim do t'ia procedojë Komisionit në kohë sa më të shpejtë. Kryetarja e falënderoi zëvendësministrin dhe kërkoi që këto biseda të jenë më të shpeshta.

Albana Gashi- beri vërejtje sa i përket shpërndarjes së materialeve, ajo tha se raportet që janë për shqyrtim nuk i kemi marr me kohe, janë shpërnda me vonesë dhe se nuk ka pasur kohe të mjaftueshme për ti analizuar, duhet materiali të dërgohet disa dite më parë që të kemi hapësirë për t'i analizuar dhe të japim komentet tona lidhur me to.

Kryetarja- duke u ndërlidhur me këtë, tha se si të merret materiali nga administrata menjëherë le të shpërndahet nëpër kutizat postare, dhe në mënyrë elektronike, për të gjithë anëtarët e komisionit.

Komisioni kaloi në pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 23 maj

Procesverbali i mbledhjes së 23 majit u miratua pa vërejtje.

4. Njoftim me kërkesën e Institucionit të Avokatit të Popullit, drejtuar Gjykatës Kushtetuese për cenimin e pavarësisë së IAP-it

Kryetarja- Pasi e përshëndeti zëvendësin e Avokatit të Popullit, njoftoi Komisionin lidhur me përmbajtjen e kërkesës së Avokatit të Popullit, me të cilën është e njoftuar Qeveria, Gjykata Kushtetuese, Komisioni, Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe Kryesia e Kuvendit. Ajo tha se kërkesa e tanishme, drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e ka mbështetjen e 12 shoqërive civile, të cilat pajtohen për shfuqizimin e disa neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit.

Ajo kërkoi nga zëvendësi i Avokatit të Popullit, që lidhur me këtë çështje ta marrë fjalën.

Basri Berisha – E informoi Komisionin lidhur me kërkesën, drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Si çështje, ceku cenimin e pavarësisë kushtetuese të Institucionit të Avokatit të Popullit. Kanë qenë disa çështje për të cilat duhet të punohet në ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, por ne i kemi dërguar vetëm disa nga çështjet me kryesore. Ata kanë kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që t'i analizojë disa prej këtyre çështjeve, që kanë të bëjnë me ndërhyrjen në pavarësinë financiare të Institucionit të Avokatit të Popullit, pastaj çështje tjetër është mospajtimi i hapësirave dhe i objekteve të mjaftueshme për punë, çështja e përcaktimit të imunitetit, si dhe çështja e pagave.

Kryetarja- Kërkoi sqarim lidhur me çështjen e imunitetit dhe pyeti: Çfarë imuniteti kërkoni dhe pse e kërkoni?

Basri Berisha – Në Ligjin për Avokatin e Popullit, neni 11 theksohet se Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimtari, ose vendime që janë brenda fushës së përgjegjësisë së Institucionit të Avokatit të Popullit.

Kryetarja – Me çka rrezikoheni ju që po e kërkoni këtë imunitet?

Basri Berisha – Punonjësit punojnë në hulumtimin e rasteve të ndryshme, ne kemi kërkuar që të përfshihen edhe punonjësit.

Kurtan Kajtazi – Ne e kemi parë që keni vështirësi për ta zbatuar ligjin, por edhe vetë ligji ka mangësi dhe ka nevojë të ndryshohet edhe me raportet e fundit që do të dalin, pastaj do të fillojmë me plotësimin dhe ndryshimin e këtij Ligji dhe ku ka mangësi, ne do të përpiqemi ta ndryshojmë. Sa i përket kërkesave buxhetore, është mirë të na sillni raportin e auditivit, sepse kemi informacione që ka pasur keqpërdorime të financave.

Kymete Bajraktari – Pse është vonuar raporti i Avokatit të Popullit, sepse ai është dashur në mars t'i dorëzohet Kuvendit. Le të merren si vërejtje serioze vonesat e publikimit të raporteve, që janë të obliguar t'i paraqesin në afatin e përcaktuar.

5. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali